

KOSOVO



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

Prishtinë, 04.04.2022

Komiteti Olimpik i Kosovës ka statusin e personit juridik, është e regjistruar si organizatë joqeveritare pranë MAP si dhe i takon Lëvizjes Olimpikë duke u angazhuar që të respektojë dispozitat e Kartës Olimpikë, andaj si e tillë lidh kontrata të ndryshme, punëson si dhe angazhon persona juridik dhe fizik, të cilët janë të domosdoshëm për realizimin dhe arritjen e qëllimeve të promovimit të Lëvizjes Olimpikë, etikës në sport, qeverisjes së mirë, si dhe zhvillimit të sportit në përgjithësi.

Bordi Ekzekutiv i KOK-ut për arritjen e qëllimeve dhe misionit të vet afatshkurtër dhe afatgjatë, është pajtuar për krjimin dhe përpilimin e planit strategjik të KOK-ut (2023-2027), andaj edhe shpallet kjo:

**Thirrje publike për aplikim të kompanive eksperte për përpilimin e
“Planit strategjik të KOK për periudhën 2023-2027”**

Komiteti Olimpik i Kosovës bën thirrje publike për kompanitë vendore dhe ndërkombëtare, eksperte në krijimin dhe përpilimin e planit strategjik të KOK-ut, të cilat i plotësojnë kriteret e mëposhtme në mënyrë strikte.

Dokumenti “Plani strategjik i KOK 2023-2027” duhet të jetë i fokusuar në fushat kryesore strategjike, të cilat do të ndihmojnë në realizimin e objektivave përkatëse të KOK. Këto fusha janë:

1. Menaxhimi i brendshëm i organizatës;
2. Burimet financiare;
3. Marketingu dhe sponsorizimi;
4. Përfaqësimi medial;
5. Financat e KOK;
6. Bashkëpunimi me federatat kombëtare sportive;
7. Bashkëpunimi me institucionet e jashtme (Ministrinë e Sportit, Qeverinë e Republikës së Kosovës, etj);

Kompania, e cila do të kontraktohet për kryerjen e këtij shërbimi, do të vlerësohet nga cilësia e saj, dhe bazuar në numrin e planeve strategjike në fushën e sportit të suksesshme, të cilat i ka realizuar. Bazuar në këtë, detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të kompanisë, janë si në vijim:

- a) Të përgatisë pyetësor për palët kryesore të interesit në sport (Komiteti Olimpik, federatat sportive, klubet e qyteteve të ndryshme, trajnerët, sportistët, qytetarët etj);
- b) Të analizojë të dhënat/informatat aktuale për Komitetin Olimpik të Kosovës;
- c) Inputet e strategjisë kombëtare në fushën e sportit në Kosovë (2023-2030) për KOK;
- d) Të punohet rreth planit strategjik të KOK për të paktën 25 ditë radhazi;
- e) Të përgatitet drafti dhe versioni final deri më së largu më 31 dhjetor 2022.

Për secilën detyrë dhe përgjegjësi të përshkruar më lartë, mund të kërkohet raport nga KOK.

Kompania e cila do të aplikojë për këtë shpallje publike nga KOK, së bashku me ofertën e detajizuar duhet të bashkangjesë edhe dokumentet e tjera, siç janë: certifikatat e biznesit, CV e ekspertëve të kompanisë, të cilët do të merren me përpilimin e strategjisë së sportit në Kosovë, dëshmitë e sukseseve të tyre në të kaluarën, si dhe planin e detajizuar të veprimit.

Kjo shpallje do të jetë valide (e hapur) për 20 ditë radhazi, respektivisht data e fundit e aplikimit është më 29 prill 2022.

KOK do të shpallë njoftimin e kompanisë, e cila është përzgjedhur për lidhjen e kontratës publike dy (2) ditë pas përfundimit të shpalljes.

Kompanitë kanë afat për ankesa (në rast të ndonjë pakënaqësie) 10 ditë nga dita e marrjes së njoftimit të përzgjedhjes së kompanisë nga KOK.